

PËRMIRËSIMI I EDUKIMIT MBI MENAXHIMIN SHËNDETËSOR NË SHQIPËRI

Bazuar në gjetjet kryesore nga rishikimi i programit të Masterit Profesional në Menaxhim Shëndetësor Management

ÇËSHTJET E MENAXHIMIT NË SISTEMET SHËNDETËSORE

Sipas studimeve të fundit, menaxhimi mund të rrisë vlerën e krijuar nga profesionistët dhe organizatat e sistemeve shëndetësore¹²³. Performanca e organizatave dhe sistemeve të kujdesit shëndetësor është e ndërlidhur me praktikën e menaxhimit, lidhshmërinë, karakteristikat e menaxherit dhe veçoritë kulturore⁴.

Praktikat e menaxhimit përfshijnë planifikimin, buxhetimin, organizimin, rekrutimin e stafit dhe kontrollimin, dhe dallimin e tyre nga proceset e zgjidhjes së problemeve dhe lidhshmërinë, të cilat përcaktojnë drejtimin dhe motivojnë e organizojnë njerëzit⁵.

Gjatë dy dekadave të fundit, shumica e sistemeve shëndetësore i kanë riorganizuar vazhdimisht strukturat dhe qeverisjen e tyre, por këto përpjekje do të jenë të pamjaftueshme nëse nuk shoqërohen me zhvillimin e qartë afatgjatë të kapaciteteve menaxheriale⁶.

Menaxhimi ka pasojë për performancën organizative, por në shumicën e rasteve këto pasojë ndikohen nga konteksti⁴.

KONTEKSTI I MENAXHIMIT SHËNDETËSOR NË SHQIPËRI

Gjatë 30 viteve të fundit, sistemi shëndetësor në Shqipëri i është nënshtruar proceseve të rëndësishme dhe radikale të organizimit/reformimit, të cilat deri më tani nuk kanë arritur të përballojnë në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme nevojat shëndetësore të popullsisë.

Arsyet mund të jenë të shumta dhe të ndryshme, por si arsyt më të rëndësishme mund të përmendim nënfinancimin, ndryshimet e shpeshta politike të prioritetëve (duke pasur parasysh faktin se organizatat e kujdesit shëndetësor janë subjekt i vendimeve financuese nga ana e autoriteteve politike), kapacitetet e pamjaftueshme politikëbërëse, kapacitetet e dobëta menaxheriale, dhe numrin e kufizuar të profesionistëve të trajnuar në bazë të nevojës dhe performancës.

Në përgjithësi, programet e menaxhimit shëndetësor janë shpërfillur në sistemin shëndetësor në Shqipëri. Për rrjedhojë, kapacitetet menaxheriale të organizatave të kujdesit shëndetësor janë kufizuar në përvojën e drejtuesve të tyre ose në të nxënësit praktik. Të qenit menaxher shëndetësor konsiderohet ende një pozicion pune për të cilin nuk kërkohet as formim i veçantë dhe as zhvillim profesional. Përkundrazi, menaxherët shëndetësorë përbëjnë një kategori të veçantë profesionale. Rrjedhimisht, edukimi mbi menaxhimin shëndetësor përfshin si më poshtë:



- Edukimi në nivel universitar. Në Shqipëri, lënda(-ët) e menaxhimit shëndetësor është pjesë e programeve studimore universitare mjekësore në Universitetin e Mjekësisë, dhe sigurisht në universitete të tjera ku zhvillohen shkencat mjekësore (mjekësi, stomatologji, farmaci, shëndet publik, infermieri, etj.)
- Programet e nivelit pasuniversitar përfshijnë Masterin Profesional ose programet e Masterit me profil kërkimin. Në Shqipëri, Masteri Profesional në Menaxhim Shëndetësor, nën përgjegjësinë e Fakultetit të Mjekësisë, filloi për herë të parë në vitin akademik 2017-2018. Përpara këtij viti, janë ofruar disa kurse (çertifikata) pasdiplomimi në menaxhim shëndetësor nga donatorë të ndryshëm, por të papërfshirë në programet e rregullta studimore të universitetit. Prandaj ofrimi i tyre ndërpritej pas përfundimit të mbështetjes nga organizatat ndërkombëtare. Në Shqipëri nuk ka programe doktorature në menaxhim shëndetësor.
- Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional. Në Shqipëri nuk ekziston një sistem i detyrueshëm për edukimin në vazhdim për menaxherët shëndetësorë. Projekti i qeverisë zvicerane Shëndet për të Gjithë, ka mbështetur trajnime afatshkurtra të akredituara, të cilat janë zhvilluar dhe ofruar për një numër të kufizuar të menaxherëve të qendrave të kujdesit shëndetësor parësor, të spitaleve dhe ekipeve të tyre menaxheriale.

Procedurat/kriteret aktuale të punësimit për menaxherët e organizatave shëndetësore nuk përfshijnë as dëshmi të diplomës/çertifikatës specifike në menaxhim shëndetësor, dhe as çertifikata të trajnimeve gjatë ushtrimit të detyrës. Ndryshimi i fundit në Ligjin për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë (Nr. 27/2019) nuk ia doli ta bëjë ligjërisht të detyrueshme futjen e këtyre kriterëve të punësimit, duke lënë një sugjerim të paqartë se pas emërimit të tyre, drejtorëve të institucioneve shëndetësore do t’iu kërkohet të ndjekin disa kurse edukimi/trajnimi në menaxhim shëndetësor. Megjithatë, kjo nuk mjafton. Duke qenë se organizatat shëndetësore dhe spitalet në veçanti po riorganizohen rreth koncepteve si, kujdesi i fokusuar, drejtoritë klinike, dhe linjat e produkteve ose shërbimeve shëndetësore, shumë studime sugjerojnë se kërkohen aftësi menaxheriale për të drejtuar në mënyrë efektive modelet e reja organizative, të cilat në fund të fundit kontribuojnë në performancë më të mirë klinike dhe financiare të organizatës shëndetësore⁷.

MESAZHET KYÇE LIDHUR ME KONTEKSTIN E MENAXHIMIT SHËNDETËSOR NË SHQIPËRI

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS) duhet të rishikojë politikat e punësimit dhe rekrutimit nëpërmjet detajimit dhe përfshirjes së kriterëve strikte lidhur me historikun arsimor gjatë procesit të rekrutimit të menaxherëve shëndetësorë.



Këto kritere mund të përfshijnë diplomimin e suksesshëm në Masterin Profesional në Menaxhim Shëndetësor dhe/ose kurse të tjera të njohura dhe të akredituara në këtë fushë. Lidhur me këtë vlen të përmendim se nevojitet koordinim më i mirë ndërmjet institucioneve përgjegjëse.

- Menaxherët nuk duhet të trajnohen vetëm për aftësitë teknike bazë mbi menaxhimin e shërbimeve shëndetësore, por edhe të edukohen/trajnohen në vazhdimësi për të konsoliduar aftësitë e tyre menaxheriale dhe të njihen me reformat aktuale që prekin sektorin e shëndetësisë në vend. Prandaj, MShMS-ja duhet ta konsiderojë ngritjen e një sistemi të detyrueshëm për Edukimin në Vazhdim të menaxherëve shëndetësorë një prioritet të rëndësishëm. Sistemi i edukimit në vazhdim mund të krijojë kushtet për rritje të ofertës dhe kërkesës për trajnim në menaxhim shëndetësor, duke çuar në krijimin e një numri të tillë menaxherësh profesionistë që mund të ndikojnë në rritjen e performancës organizative dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

MASTERI PROFESIONAL NË MENAXHIM SHËNDETËSOR NË SHQIPËRI

Organizimi dhe zhvillimi i programit të Masterit

- Për herë të parë në Shqipëri, që prej vitit 2017, programi i masterit profesional në menaxhim shëndetësor (MMSH) po zhvillohet bashkërisht nga dy universitete: Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (Departamenti i Shëndetit Publik në Fakultetin e Mjekësisë) dhe Universiteti i Tiranës (Departamenti i Menaxhimit në Fakultetin e Ekonomisë). Diploma e masterit lëshohet nga Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë. Zhvillimi dhe ofrimi i MMSH-së është mbështetur nga Projekti Shëndet për të Gjithë (HAP), i financuar nga SDC-ja, dhe përfshin asistencën teknike të ofruar nga Instituti Zviceran i Shëndetit Publik dhe Mjekësisë
- Tropikale i Bazelit, Zvicër. Aktualisht, programi po zhvillohet për kohortën e tretë dhe konsiderohet një program i dobishëm dhe i mirëorganizuar, i cili duhet të vijojë dhe të rrisë më tej cilësinë dhe përfitimet e menaxherëve të ardhshëm shëndetësorë.
- Masteri në Menaxhim Shëndetësor është një program me kohë të plotë dhe zgjat një vit akademik (dy semestra). Numri total i krediteve (ECTS) është 60, që është i barasvlershëm me 1500 orë pune (angazhim i studentëve). Kurrikula e programit të MMSH-së konsiston në 10 lëndë (të cilat përfshijnë 14 module) dhe tezën përfundimtare.
- Kandidatët e interesuar për të ndjekur masterin duhet të kenë përfunduar një cikël të plotë studimesh (studime bachelor dhe master) në një prej programeve të mëposhtme: mjekësi, shëndet publik, infermieri, drejtësi ose ekonomi. Qëllimi i këtyre kritereve ishte rekrutimi i kandidatëve të vlefshëm me përvojë, punësimi i të cilëve me shumë gjasë do të vazhdojë në sektorin e shëndetësisë.
- Procesi i zhvillimit të kurrikulës u realizua me pjesëmarrjen e të dy fakulteteve. Në këtë rrugëtim, HAP-i ofroi mbështetje të rëndësishme nëpërmjet angazhimit të ekspertëve të Swiss TPH dhe mbështetjes për pjesëmarrje të stafit mësimdhënës të masterit në modulet e trajnimit në Bazel (Zvicër), në kuadër të Masterit në Menaxhim Shëndetësor Ndërkombëtar.
- Të gjitha modulet e programit janë vlerësuar pozitivisht nga studentët, pasi kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve të menaxherëve shëndetësorë. Megjithatë, ata konfirmuan se raporti teori-praktikë është shumë në favor të teorisë.
- Në programin e masterit mungon stazhi si një modul i veçantë, nevoja për të cilin është evidentuar nga studentët dhe të diplomuarit.
- Aktualisht, pjesa më e madhe e tezave individuale të masterit duket të jenë të jenë më shumë të tipit kërkimor tradicional sesa

një projekt i orientuar nga praktika, çka do ta bënte këtë program të përshtatej më mirë me një program të masterit profesional.

- Programi aktual nuk përfshin modul(-e) të menaxhimit spitalor, çka mund të rezultojë në kufizim të aftësive dhe shprehive të studentëve të tij në këtë aspekt.

Koordinimi ndërmjet dy departamenteve/ fakulteteve dhe promovimi i Masterit

- Të dyja departamentet kanë përgjegjësi të ndara qartë për sa i përket zhvillimit dhe ofrimit të mësimdhënies: 5 module nën përgjegjësinë e departamentit të shëndetit publik, 2 nën përgjegjësinë e të dy departamenteve, atij të shëndetit publik dhe të menaxhimit, dhe 7 module nën përgjegjësinë e departamentit të menaxhimit. Gjithashtu, ka edhe marrëveshje ndërmjet fakulteteve lidhur me aspektet administrative, ligjore dhe teknike të programit. Proceset administrative, logjistike dhe të komunikimit janë përgjegjësi e Departamentit të Shëndetit Publik (FM), ndërsa procesi i mësimdhënies është zhvilluar në mjedise të dedikuara për këtë master në të dy fakultetet.
- Infrastruktura në të dy fakultetet u dëmtua nga tërmeti i nëntorit të vitit 2019, nga i cili FM-ja u prek më rëndë.
- Për të lehtësuar komunikimin, shkëmbimin e materialeve mësimore, dhe detyrave

ndërmjet studentëve dhe pedagogëve, gjatë vitit akademik 2019-2020 u krijua platforma online Moodle me mbështetjen e HAP-it. Pas izolimit të vendit për shkak të pandemisë COVID-19 në mars të vitit 2020, i gjithë procesi mësimor u zhvillua online, çka solli pengesa serioze për mbarëvajtjen normale të proceseve të të nxënit.

- Programi i masterit reklamohet kryesisht në faqet e internetit të Fakultetit të Mjekësisë dhe në kanalet e komunikimit të HAP-it (faqe interneti, media sociale, komunikim përmes postës direkte). HAP-i ka nxitur në veçanti vizibilitetin e programit, duke i komunikuar online dhe me dokumente kandidatëve të interesuar programin e detajuar të masterit (p.sh., botimi i broshurës së masterit, promovimi i veprimtarive mësimore, etj.). Megjithatë, marketimi i programit është ende i ulët dhe i fragmentuar.

MESAZHET KYÇE PËR PËRMIRËSIMIN E MASTERIT NË MENAXHIM SHËNDETËSOR

Përmbajtja dhe përshtatshmëria e programit

- Departamenti i Shëndetit Publik në bashkëpunim me Departamentin e Menaxhimit duhet të rishikojnë strukturën e përgjithshme të programit me disa objektiva:
 - a) Mundësisht të shtohet moduli i



- menaxhimit spitalor (ose një set modulesh) si një lëndë e vetme ose si një profil i dytë masteri;
- b) Të përfshihet stazhi si një kurs i detyrueshëm i programit. Ky ndryshim duhet shoqëruar me një marrëveshje ndërmjet Universitetit dhe organizatave shëndetësore, duke përfshirë shpërbimin përkatës për mentorët e stazhit.
 - c) Të vlerësohet bashkimi/ndarja/modifikimi i kohëzgjatjes së moduleve aktuale në bazë të një seti të përditësuar të njohurive dhe aftësive për t'ia ofruar çdo studenti;
 - d) Të ecet përpara drejt rishikimit në vazhdimësi të moduleve duke shtuar dhe strukturuar më mirë seminarët dhe ushtrimet praktike.
- Të bëhet i mundur kalimi nga tezat e masterit të tipit kërkimor tradicional në tezat si një projekt të bazuar në stazh për të kontribuar edhe nëpërmjet përgatitjes së tezës së masterit në zhvillimin e setit të aftësive dhe përgjegjësive të menaxherëve të ardhshëm shëndetësor. Në këtë aspekt, DShP-ja në bashkëpunim me DM-në duhet të rishikojnë udhëzimin e propozuar nga HAP-i mbi mënyrën e organizimit të tezës së bazuar në raportin e stazhit, duke filluar nga planifikimi i saj, identifikimi i temës, mjetet e mbështetjes, deri në prezantimin e saj përfundimtar.
 - HAP-i në bashkëpunim me DShP-në dhe DM-në duhet të identifikojnë dhe mbështesin çdo nismë që sjell përmirësim të qëndrueshëm për mjedisin e të nxënit (si shembull, mund të përmendim rehabilitimin e klasës së dedikuar MMSH-së në Departamentin e Menaxhimit).
 - Për shkak të pandemisë aktuale mbarëbotërore COVID-19 sistemi i menaxhimit të mësimit online të konsiderojë veçoritë e mëposhtme: a) kombinimi i teknikave të mësimdhënies së njëkohshme, si dhe një video shpjeguese; b) funksioni i regjistrimit të leksioneve dhe diskutimeve në grup për konsultim të mëtejshëm, jashtë orëve virtuale “në klasë”; c) përshtatja e lehtë me pajisjet e ndryshme elektronike (laptopë, celularë, etj.); d) mundësia për të zëvendësuar mësimet në klasë (në rast nevojë), etj. Ky sistem duhet të krijohet dhe përmirësohet më tej në të dyja fakultetet për të mbështetur programin e masterit.
 - Departamenti i Shëndetit Publik në bashkëpunim me Departamentin e Menaxhimit duhet të nxisin procesin e kalimit të ofrimit të diplomës së MMSH-së, nga Diplomë e lëshuar vetëm nga FM në një diplomë të përbashkët, të lëshuar nga të dyja fakultetet/universitetet. Ky ndryshim do të krijojë një kuadër rregullator të favorshëm për zbatimin e rekomandimeve të sipërpërmendura.
 - Departamenti i Shëndetit Publik (DPSH) në bashkëpunim me Departamentin e Menaxhimit (DM) duhet të rishikojnë kriteret e aplikimit për të përmirësuar cilësinë e kandidatëve të interesuar, lidhur me motivimin e tyre për angazhimin e nevojshëm për të përmbushur kërkesat e procesit mësimor dhe për të ruajtur dhe rritur interesin e tyre për karrierë në menaxhim shëndetësor. Një kriter i ri mund të jetë intervistimi i kandidatit në fazën e përzgjedhjes.
 - FM/DShP duhet të intensifikojnë komunikimin me MShMS-në për të lobuar mbi përfshirjen e diplomës së masterit në menaxhim shëndetësor në kriteret e rekrutimit të menaxherëve shëndetësorë.

Promovimi i Masterit në Menaxhim Shëndetësor

- Promovimi i programit nga Fakulteti i Mjekësisë duhet të bëhet gjatë gjithë kursit. Është e rëndësishme që njoftimi për kursin e ri para fillimit të vitit të ri akademik të bëhet disa muaj përpara publikimit të thirrjes për aplikime të reja, së bashku me kriteret e aplikimit. Fakulteti i Mjekësisë/DShP-ja duhet të jenë më aktivë në përdorimin e medias sociale, si dhe të medias tradicionale për të publikuar informacion mbi masterin.

- Për të promovuar dhe konsoliduar programin e MMSh-së, Departamenti i Shëndetit Publik (DShP) në bashkëpunim me Departamentin e Menaxhimit (DM) duhet të: mbështesin krijimin dhe forcimin e rrjetit të të diplomuarve të këtij programi;

marrin në konsideratë organizimin e konferencave/takimeve dedikuar temave lidhur me menaxhimin shëndetësor; përfshijnë politikëbërësit dhe menaxherët e suksesshëm shëndetësorë në aktivitete të ndryshme të programit të MMSh-së, etj.

Referenca

- 1 Kaplan R, Porter M. Si të zgjidhim krizën e kostove në kujdesin shëndetësor [How to solve the cost crisis in health care.] Harvard Bus Rev. Shtator 2011: 47-64
- 2 Spurgeon P., Clark J., Ham C. Drejtimi mjekësor: Nga errësira në dritë [Medical leadership: From the Dark Side to Centre Stage.] Londër: Radcliffe Publishing 2011
- 3 Ham C. Menaxhimi i Shërbimit Kombëtar Shëndetësor (NHS) në Angli [The management of the NHS in England.] BMJ 2012; 344: e928
- 4 Lega F., Prenestini A., Spurgeon P. Elsevier Inc. Vlera në Shëndet [Value in Health] 16 (2013) S46-S51
- 5 Kotter JP. Të udhëheqësh ndryshimin [Leading Change.] Boston: Harvard Business School Press, 1996
- 6 Lega F. Dritëhijet në marginalizimin e Shërbimit Kombëtar Italian Shëndetësor [Lights and shades in the managerialization of the Italian National Health service.] Health Serv Res 2008;21;248-61
- 7 Ham C. Përmirësimi i performancës së shërbimeve shëndetësore: roli i drejtimit klinik [Improving the performance of health services: the role of clinical leadership.] Lancet 2003: 361 1978-80

Deklaratë për mospranim përgjegjësie

Ky dokument bazohet në “Rishikimin e programit të Masterit Profesional në Menaxhim Shëndetësor”, të kryer nga Prof. Asoc. Fabian Cenko dhe Prof. As. Dr. Eliona Kulluri Bimbashi. Rishikimi dhe hartimi i këtij dokumenti është mbështetur nga Projekti Shëndet për të Gjithë, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i zbatuar nga Instituti Zviceran i Shëndetit Publik dhe Mjekësisë Tropikale (STPH).

Këndvështrimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të SDC-së, STPH-së apo HAP-it.

Një projekt i Agjencisë Zvicerane
për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



Zbatuar nga:

Swiss TPH 
Swiss Tropical and Public Health Institute